

Rreth përdorimit të dialektit dhe gjuhës standarde



Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes

Nxitje didaktike

Broshurë plotësuese 1



Rreth përdorimit të dialektit dhe gjuhës standarde

Basil Schader

Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes

Nxitje didaktike

Broshurë plotësuese 1

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» (MGJP; në Zvicër GJKA: Mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut); Nxitje didaktike 1; broshurë plotësuese 1.

Botuar nga dega ,Zhvillim ndërkombëtar i arsimit' (International Projects in Education) e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut.



Udhëheqës i projektit:	Basil Schader
Autori:	Basil Schader, Prof. Dr. Dr., udhëheqës i projekteve në IPE të SHLP (PH Zürich) në Cyrih, ekspert për didaktikën ndërkulturore, autor tekstesh mësimore
Redaktimi nga ana e MGJP testimi:	Nexhat Maloku, M.A., mësues i GJKA, kryetar i Lidhjes së Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë «N. Frashëri» në Zvicër
Ilustrimet, koncepti i përgjithshëm pamor dhe realizimi:	Barbara Müller, Erlenbach
Përkthimi:	Nexhat Maloku, M.A.
Lektorati:	Prof. Dr. Naxhi Selimi, PHSZ
Shtypi:	Shtëpia botuese Dukagjini, Pejë/Kosovë, 2018.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» u mundësua me përkrahjen e Entit Federal për Kulturë (BAK).



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Eidgenössisches Departement des Innern EDI
Bundesamt für Kultur BAK

Ky projekt u financua pjesërisht me përkrahje të Komisionit Evropian. Përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij botimi e bartin vetë hartuesit/et; Komisioni nuk merr përgjegjësinë për përdorimin e mëtejshëm të të dhënave të përmbajtjes.



Lifelong
Learning
Programme

Numri ISBN i botimit përkatës gjermanisht:	ISBN 978-3-280-04180-2
--	------------------------

Pasqyra e përmbajtjes

Parafjalë rreth serisë «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes»

7

Hyrje

1	Historiku, qëllimi dhe struktura e këtij doracaku	8
2	Për çfarë bëhet fjalë	8
3	Vështirësitë dhe shkaqet e tyre	9
4	Sfonde linguistike dhe pragmatike	10
5	Aspekte pedagogjike	10
6	Aspekte didaktike	11
7	Propozime konkrete për mësim	11
8	Formulimi i pyetjeve kryesore dhe propozime të përshtatshme mësimore për to	13

1

Pjesa 1: Të zgjohet dhe të zhvillohet ndërgjegjësimi për varietetet dialekt(e) – gjuhë standarde

1.1	Bisedë hyrëse, ndërgjegjësimi i parë	16
1.2	Thellim në vazhdim të detyrave nga 1.1 (në javën e ardhshme)	17
1.3	Kur dhe cila formë gjuhësore është e përshtatshme: reflektim, ndërgjegjësim	18
1.4	Çfarë duam dhe kemi nevojë të mësojmë nga dhe në gjuhën standarde?	19
1.5	Thellim në drejtshkrimin e gjuhës sonë standarde	20

2

Pjesa 2: Situata të lojës dhe aktivitete kreative për sensibilizimin ndaj varieteteve dialekt(e) – gjuha standarde

2.1	Ndjeshmëria akustike	22
2.2	Skena të vogla dhe skeçe për përdorimin e përshtatshëm të të dy varieteteve	22

2.3	Skicime gjuhësore	23
2.4	«Poezi njëmbëdhjetëshe» në dialekt(e) dhe në gjuhën standarde	23
2.5	Flluska folëse për foto ose piktograme në dialekt dhe në gjuhën standarde	24

3 Pjesa 3: Të mësuarit zbulues për temën dialekt(e) – gjuha standarde

3.1	Krahasimet dhe përkthimet dialekt – gjuhë standarde	26
3.2	Krahasime thelluese dhe ndërgjegjësimi për dialektin(et) – gjuhën standarde	27
3.3	Paraqitja veç e veç e dialekteve dhe veçantitë e tyre	28

4 Pjesa 4: Reflektim gjuhësor për temën dialekt(e) – gjuhë standarde

4.1	Përse ka dialekte/të folme dialektore dhe gjuhë standarde?	30
4.2	Rreth prestigjit të dialekteve/të folmeve dialektore dhe gjuhës standarde	32
4.3	Gjuha jonë: thellim në ndryshimin e gjuhës dhe të fjalëve të huaja	33
4.4	Përdorimi i gjuhës në mediet e reja (SMS, e-mail, chat, etj.)	34

Propozim për planifikimin mësimor	35
--	----

Literatura e përdorur	38
------------------------------	----

Sqarimet, shkurtesat

Gjuha e parë:	Edhe gjuhë amtare – ose familjare: gjuha të cilën një fëmijë e ka mësuar dhe folur si gjuhë të parë në shtëpi. Mjaft fëmijë kanë dy gjuhë.
---------------	---

Gjuha shkollore:	Gjuha e cila flitet në shkollën e vendit emigrues. Gjithashtu mund të vijë edhe dialekti lokal si gjuhë e rrethit
------------------	---

Shkurtesat:	N = Nxënës, nxënëse M = Mësues, mësuese
-------------	--

Legjenda

për të dhënat për formën sociale, klasën dhe kohën e nevojshme tek
propozimet mësimore:



PI = Punë individuale



PP = Punë me partner



GV = Grup i vogël



TK = Tërë klasa

kl. 1–9

E përshtatshme për klasat ... deri ... (p.sh. kl
2–4). Kujdes: Kjo renditje mund të ndryshojë
sipas parakushtit të nxënësit,-es veç e veç.

10–15 min.

Nevoja për kohë të përafërt, p.sh. 20 min.
(e dhënë e përafërt, duhet të vendoset nga
mësimdhënësi sipas gjendjes së parakushteve
të klasës).

Parathënie për serinë «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes»

Mësimi në gjuhën amtare ose të prejardhjes (MGJP; në Zvicër GJKA, mësimi në gjuhën dhe kulturën e atdheut) luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin gjuhësor dhe të identitetit si dhe për përkujdesjen për shumëgjuhësinë, si një rekurs vetjak dhe shoqëror me shumë vlerë. Lidhur me këtë fakt, hulumtimet, linjat drejtuese, si edhe rekomandimet e Këshillit të Evropës R(82) 18 dhe R (98) 6, janë të qarta që prej shumë kohësh. Megjithatë ky mësim zhvillohet, në krahasim me mësimin e rregullt, ende në kushte të vështira. Kjo gjë ndodh për arsye të ndryshme:

- Mësimi në gjuhën e prejardhjes në shumë vende, përsa i përket aspektit financiar dhe institucional, qëndron në themele të dobëta. Pagesa e mësimdhënësve në Zvicër është pothuaj si kudo çështje e vendeve të prejardhjes madje edhe e prindërve.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes është më së shumti i lidhur jo mirë me mësimin e rregullt. Kontaktet dhe bashkëpunimi me mësimdhënësit e klasave të rregullta, shpesh zhvillohen shumë dobët.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes zhvillohet në më të shumtën vetëm dy orë në javë, gjë që e vështirëson punën në vazhdimësi.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes është, në të shumtën, vullnetarisht, detyrimi për nxënësit nuk është shumë i fortë.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes, si rregull, zhvillohet si mësim në shumë klasa, në të cilin marrin pjesë njëkohësisht nxënës që nga klasa e parë e deri në klasën e nëntë. Kjo kërkon nga mësimdhënësit aftësi të lartë didaktike si edhe aftësi për të diferencuar nxënësit në klasë.
- Heterogjeniteti i bashkësisë së nxënësve në mësimin e gjuhës së prejardhjes është veçanërisht shumë i lartë edhe në raport me kompetencat gjuhësore të nxënësve, ndërkohë kur disa sjellin nga shtëpia njohuri të mira në variantet dialektore ose të standardit të gjuhës së parë, të tjerë e flasin këtë vetëm në dialekt. Shumica që jeton tashmë në gjeneratën e dytë apo të tretë në vendin e ri të emigrimit, gjuha e atij vendi (p.sh. gjermanishtja) është bërë gjuhë e fortë, derisa gjuhën e parë e zotërojnë vetëm në variantin dialektor, dhe atë vetëm gojarisht dhe me një leksik të kufizuar rreth temave familjare.

- Mësuesit e gjuhës së prejardhjes parimisht kanë marrë në vendet e tyre të prejardhjes një arsimim të mirë bazë, por nuk janë të përgatitur për realitetin dhe specifikat e mësimin në shkollat me shumë klasa në emigrim. Mundësitë e kualifikimit në vendet e emigrimit zhvillohen në masë ende të pamjaftueshme.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» i përkrah mësimdhënësit e këtij mësimi në detyrën e tyre të rëndësishme e me kërkesa të larta, e me këtë dëshiron të japë ndihmesë për një cilësi maksimale të tij. Nga njëra anë është me rëndësi dhënia e principeve dhe e arsyeve të pedagogjisë dhe didaktikës në vendet emigruese perëndimore dhe evropianoveriore, (krahaso fletoren «Bazat dhe sfondet») nga ana tjetër dhënia e shtysave dhe modeleve mësimore praktike e konkrete. Përparësi përbën këtu përkrahja e kompetencave gjuhësore. Tek shtysat didaktike në mënyrë të vetëdijshme përdoren principet dhe metodat, të cilat për nxënësit janë të njohura nga mësimi i rregullt dhe tekstet mësimore përkatëse. Për këtë do të duhej që mësimi në gjuhën e prejardhjes dhe mësimi i rregullt, mundësisht t'i afrohen njëri-tjetrit në kuptim të një koherence të madhe. Përmes faktit që mësimdhënësit e mësimin në gjuhën e prejardhjes, njohin edhe elemente didaktike dhe metoda konkrete, që janë aktuale tek nxënësit në mësimin e rregullt, ata bëjnë njëkohësisht një pjesë kualifikimi dhe shpresojmë për një forcim të formimit të tyre si partnerë të barasvlershëm në procesin arsimor me nxënësit e rritur në sfondin dygjuhësor respektivisht dykulturor.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» botohet nga Qendra «International Projects in Education (IPE)» dhe Shkolla e Lartë Pedagogjike Cyrih. Ajo lindi mes një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet personave profesionistë zviceranë, atyre evropianoperëndimor në njërin anë, dhe të ekspertëve e mësimdhënësve të mësimin në gjuhën e prejardhjes, nga ana tjetër. Me këtë do të sigurohet se dhënia e informacioneve dhe e shtysave u përgjigjet gjendjes faktike, nevojave dhe mundësive të mësimin në gjuhën e prejardhjes dhe se janë funksionale e praktike për këtë mësim.

1. Historiku, qëllimi dhe struktura e këtij doracaku

Ky doracak i plotëson gjashtë vëllimet e mëparshme të serisë «Materiale për mësimin në gjuhën e preardhjes». Këtu trajtohet një temë e cila në kontakt me mësuesit/-et e mësimin në gjuhën e preardhjes ka shkaktuar vazhdimisht diskutime në fokusin e së cilave ishte kjo çështje themelore: «Si t'i përdorim ne si mësues në mënyrë sa më të mirë varietetet, gjegjësisht format gjuhësore, pra, gjuhën standarde dhe dialektet/ të folmet dialektore?» Diskutime të shumta dhe pyetje të hapura në lidhje me këto çështje ishin arsyt kryesore për hartimin e këtij doracaku.

Qëllimi i këtij doracaku është që t'i përkrahë mësuesit/-et nëpërmjet të të dhënave themelore të cilat paraqiten në hyrje të tekstit, si dhe me 17 propozimet konkrete të cilave u bashkëngjitet edhe një planifikim mësimor në pjesën praktike. Në të njëjtën kohë, këtu do të ilustron se si një temë e cila në shikim të parë duket e thatë, mund të paraqitet në mënyrë më kërkuese dhe të orientuar në kontekstin shkollor. Rruga për ta arritur këtë është orientimi didaktik në principet e të mësuarit veprues, zbulues e reflektues dhe integrimi i situatave mësimore, muzikore-kreative e të lojës.

Duhet shtuar se përpos varieteteve dialektore/të folmeve dialektore dhe gjuhës standarde, natyrisht ka edhe varietete të tjera brenda secilës gjuhë. Janë për tu theksuar sociolektet (varietetet gjuhësore specifike të grupeve, si p.sh., tek të rinjtë ose gjuha e akademikëve) ose gjuha e terminologjisë faktike, por edhe lartësitë e ndryshme të stilit gjuhësor (nga ai tepër shoqëror e deri shumë formal), specifika e gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, dimensionin historik ose gjuha e përdorur e „përzier“ (Code-Switching, Code-Mixing, shih më poshtë). Në këtu nuk do të merremi me të gjitha këto aspekte të përdorimit gjuhësor – dhe as me temën e përgjithshme për reflektimin gjuhësor, në kuadër të së cilës do të ishin nënrenditur këto forma.

Është më kuptimplote që në kuadër të këtij doracaku përmbledhës, së pari të fokusohemi në temën aktuale dialektet/gjuha standarde. Një publikim i mëvonshëm mbi reflektimin gjuhësor dhe varietetet gjuhësore do të ishte shumë i dëshirueshëm. Megjithatë, këtu bëhet fjalë për një temë me mundësi të mëdha për një mësim të drejtuar nga resurset dhe për të mësuarit zbulues e kreativ.

Mbarështimi i këtij doracaku:

Hyrja ofron së pari një informacion të shkurtër përmbytësor për temën dialekti(et) – gjuha standarde dhe shanset e problemet e lidhura me të (kap. 2–4). Në vazhdim pasojnë ca udhëzime dhe ngërthimet mbi aspektet pedagogjike dhe didaktike (kap. 5–6) si dhe një seri me shembuj konkret mësimor (kap. 7). Hyrja përmbyllet me një vështrim tabelor rreth çështjeve kryesore dhe propozimeve mësimore të lidhura me këto çështje.

Pjesa praktike përfshin 17 propozime konkrete mësimore, të cilat janë ndarë në aspektin tematik në katër grupe. Propozimet konkrete do të paraqiten si kurse në broshurat e deritanishme, tashmë të provuara dhe zbatuara në praktikë. Përfundimin e kësaj pjese e përbën sugjerimi për planifikimin e tri blloqeve me nga 5, 6 dhe 4 leksione.

Falënderim:

Për këshillimet profesionale dhe vështrimin kritik të tekstit i falënderojmë (sipas renditjes alfabetike) Erica Bauhofer, Nuhi Gashi, Nexhat Maloku, Naxhi Selimi, Gjovalin Shkurtaç, Peter Sieber.

2. Për çfarë bëhet fjalë

Në shumë gjuhë bashkëjetojnë njëra pranë tjetrës forma të ndryshme, gjegjësisht varietete: në njërin anë gjuha flitet në dialekte ose të folme dialektore të ndryshme regjionale, në anën tjetër për një fushë të tërë gjuhësore është e vlefshme gjuha letrare ose standarde. Për regjionet përkatëse nga kjo krijohet një situatë e dygjuhësisë (rreth terminologjisë shih më poshtë).

Varësisht nga gjuha dhe regjioni, të dy varietetet (respektivisht variantet ose format) gëzojnë famë të ndryshme: dialektet shihen shpesh si diçka e dorës së dytë dhe, për më tepër, të folurit në dialekt perceptohet si shenjë e arsimimit dhe kulturës së pamjaftueshme. Në vende të tjera (si p.sh., në Zvicrën gjermanishtfolëse) dialektet gëzojnë prestigj të lartë; këtu edhe akademikët komunikojnë natyrshëm në dialekt. Në kontekst të regjionalizimit dialektet dhe dialektet lokale fitojnë në prestigj, si në Kosovë (dialekti gegë i shqipes) ose në Gjermani, ku flitet për një lloj „renaissance të dialekteve“. Kjo korrespondon edhe me faktin se në mediet e reja (SMS, chats, e-mail, facebook etj.) para së gjithash tek të rinjtë, dialekti përdoret gjithnjë e më shumë, si në komunikimin joformal ashtu edhe me shkrim.

3. Vështirësitë dhe shkaqet e tyre

Në mësimin e gjuhës së prejardhjes (MGJP) qëndrimi krahas njëri-tjetrit i dialekteve dhe gjuhës standarde mund të çojë në vështirësi. Ndër arsyet numërohen disa prej tyre:

- Shumë nxënës/-e njohin nga rrethi familjar pothuaj vetëm të folmen dialektore të familjes së tyre – dhe, edhe këtë të shumtën vetëm në formën gojore, shpesh me sfond të kufizuar fjalësh që përdoren në familje. Këto njohuri janë padyshim jo shumë gjithëpërfshirëse. Megjithatë, këto ofrojnë për fëmijën vlerë të lartë emocionale dhe identitare: bëhet fjalë për gjuhën amtare, ashtu si ajo flitet nga prindërit, familja dhe të afërmit e tij. Kushdo që e përbuz këtë gjuhë, e sulmon fëmijën në një fushë ekzistenciale të identitetit të tij gjuhësor dhe kulturor. E njëjta gjë vlen edhe për nënvlerësimin e formave gjuhësore të cilat janë karakteristike për rritjen e fëmijëve në një kontekst ndërkulturor – bilingual, veçanërisht për ‘përzierjen’ (shpesh përkohësisht) të gjuhës së parë – dhe të dytë (Code-Switching, Code-Mixing).

Në raport me nxënësit/-et e mësimin në gjuhën e prejardhjes, është me rëndësi një aspekt i dytë: pikërisht për shkak të parakushteve të tyre shpesh modeste, disa prej tyre kanë qëndrim të rezervuar dhe refuzues ndaj gjuhës standarde. Kjo ju duket atyre shumë vështirë e kuptueshme ose tepër e komplikuar. Pikërisht për t’i zvogëluar këto rezerva dhe së bashku me to edhe qëndrimin refuzues, është një nga detyrat kryesore të mësimin në gjuhën e prejardhjes. Situata mësimore të përshtatshme për moshën përkatëse dhe jo tepër sfiduese, janë rruga më e mirë për ta përmbushur këtë detyrë.

- Në mesin e mësuesve/-eve të mësimin në gjuhën e prejardhjes (gjithashtu edhe në mesin e ‘të arsimuarve’) vërejmë jo rrallë një qëndrim refuzues ndaj të folurit në dialekt (kurse në raport me Code-Switching akoma më shumë), qëndrim i cili shkon deri në pozicionet e purizmit gjuhësor. Si ‘e pastër’ dhe si ‘gjuhë me gramatikë’ konsiderohet vetëm gjuha standarde, gjegjësisht varianti standard – me ç’gjë dialekti zhvlerësohet si diçka ‘i papastër’ dhe si një përdorim gjuhësor ‘pa gramatikë’

- Një nga detyrat kryesore të mësimin në gjuhën e prejardhjes është padyshim hyrja në gjuhën standarde dhe në teknikat kulturore, gjegjësisht në fushën e kompetencave të të lexuarit dhe shkruarit. Arsyet janë të qarta: kush nuk mund të lexojë dhe të shkruajë, mbetet analfabet/-e në gjuhën e vet; kush nuk e zotëron deri diku gjuhën standarde, mbetet i përjashtuar nga kultura letrare e popullit të vet dhe nga mundësia për të komunikuar në nivel mbiregjonal. Pra, mësuesit/-et nuk e kanë fare gabim kur i japin rëndësi të madhe mësimin të variantit standard – me çka nuk përjashtohet fare vlerësimi i varieteteve tjera dhe konfrontimi me to.

Çështje terminologjike

Gjuha e parë: Në vend të përkufizimit «gjuha amtare» ose «gjuha familjare», në literaturën gjermane përdoret përkufizimi i zakonshëm «gjuha e parë».

Varieteti: Është formë specifike gjegjësisht nënsistem i një gjuhe.

Shembuj: Varietetet e gjuhës standarde dhe varietetet dialektore të një gjuhe, format specifike të përdorimit gjuhësor (sociolektet) të grupeve ose të shtresave shoqërore.

Me rëndësi: Në propozimet mësimore në vend të nocionit shkencor ‘varietet’ e përdorim nocionin ‘variant’ ose ‘formë’.

Dialekti/E folmja dialektore: Varietetet regjionale ose lokale të një gjuhe.

- Nocionet ‘dialekt’ dhe ‘e folme dialektore’ përdoren si sinonime në gjermanisht dhe në shumë gjuhë të tjera. Në gjuhët e tjera si, p.sh. në shqip, ‘dialekti’ nënkupton varietet regjional (p.sh. dialekti i Thurgaut gjegjësisht gjermanishtja e Thurgaut, dialekti gegë, gjegjësisht gegërishtja). Në të kundërtën, nocioni ‘e folme dialektore’ u referohet një-sive më të vogla (lokale) gjeografike (p.sh. e folmja dialektore e Ermatingenit në Zvicër, e folmja dialektore e Rahovecit në Kosovë).

Dialekti regjional: Një varietet i cili përfshin një zonë më të madhe të dialekteve veç e veç, p.sh., dialekti i Bajernit, gjermanishtja e Zvicrës lindore (si formë gjuhësore e shtrirë në kantonet lindore zvicerane).

Gjuha standarde (e quajtur edhe gjuhë letrare ose gjuhë e nivelit të lartë): Një varietet me normë të unifikuar, i vlefshëm për një zonë të tërë gjuhësore sa i përket gramatikës, drejtshkrimit dhe leksikut. Në raport me dialektet dhe të folmet lokale, gjuhët standarde janë shumë më të reja. Disa prej tyre u krijuan mbi

bazën e një dielekti të caktuar që mbizotëronte në një zonë të caktuar, të tjerat u formuan dhe u normuan në kuadër të konferencave. Mbetet për tu sqaruar fenomeni i të ashtuquajturit *pluri- ose policentrit*: Në disa gjuhë ekzistojnë variantet kombëtare ose regjionale të gjuhës standarde. Shembuj: anglishtja në Angli dhe në Amerikë, gjermanishtja në Gjermani, Austri dhe Zvicër, gjuha standarde shqipe në Shqipëri dhe Kosovë.

Dygyjuhësia: Ndërthurja e dy varieteteve të ndryshme të së njëjtës gjuhë (shembull dialekt(e) – gjuhë standarde) të cilat përdoren varësisht nga situata. Dygyjuhësia në medie përdoret kur – p.sh. në Zvicrën gjermanishtfolëse – një varieteti i përcaktohet mediumi i të shkruarit dhe tjetrit i përcaktohet mediumi i të folurit.

Code-Mixing, Code-Switching, translanguaging: Përdorimi i ‘përzier’ i gjuhës, në të cilën elementet (para së gjithash fjalët dhe frazat, rrallë strukturat sintaksore) e të dy gjuhëve kombinohen, gjegjësisht aktivizohen.

Përzierja e kodit është karakteristikë e shumë të rinjve në emigrim. Ata përdorin potencialin e tyre dygyjuhësor që përmban elemente të formave gjuhësore (p.sh. „gjermanishtja ballkanike”), të cilat mund të kontribuojnë edhe në identitetin e një grupi. Zhvlerësimi i mëparshëm i përzierjes së gjuhëve si një ‘përdorim i papastër’ i gjuhës, i hap sot rrugën një pamjeje më pak normative të mundësive të saj funksionale dhe identitare.

4. Sfonde linguistike dhe pragmatike

Dialektet/të folmet dialektore dhe gjuha standarde janë variante/varietete të barasvlershme të po asaj gjuhe. Megjithatë, ato ndryshojnë për sa i përket disa aspekteve gjuhësore dhe funksionale dhe, varësisht nga gjuha, edhe për sa i përket famës së tyre.

Dallimet dhe veçoritë gjuhësore mund t’iu referohen aspekteve të ndryshme: shqiptimit, fjalorit, gramatikës etj.

Vetëkuptohet që të dy varietetet (si në çdo gjuhë) kanë *gramatikën* e tyre. Gramatika e gjuhës standarde, pjesë e së cilës janë shqiptimi dhe drejtshkrimi, është e përshkruar në detaje dhe e normuar në rregulla dhe tekste mësimore, të cilat vlejnë për një zonë të tërë gjuhësore. Përshkrimet e karakteristikave gramatikore, fonetike dhe leksikore ekzistojnë gjithashtu në shumë dialekte dhe të folme dialektore. Megjithatë, këto nuk kanë karakter normativ, por deskriptiv (përshkruar) dhe zakonisht i përkasin vetëm gjuhës së folur.

Në *aspektin funksional dhe pragmatik* të dy varieteteve dallohen në mënyrë koncize: dialekti, gjegjësisht e folmja dialektore është funksional dhe i rëndësishëm në nivel regjional e lokal si medium i komunikimit joformal (p.sh. familjar). Gjuha standarde është funksionale dhe e rëndësishme si medium i përdorimit gjuhësor formal, veçanërisht në të shkruar. (Në aspektin e orientimit nga kompetencat mund të themi: Të komunikuarit në dialekt është me rëndësi për integrimin social; kompetenca në gjuhën standarde është e domosdoshme për integrimin shkollor dhe në fushën e profesionit e të karrierës.) Kështu, të dy varietetet kanë funksionalitetin dhe rëndësinë e tyre të veçantë, të cilat duhet të respektohen.

Për *famën* e gjuhës standarde dhe të dialekteve/të folmeve dialektore shih më lart tek 2. Varësisht nga gjuha dhe regjioni gjuhësor ka dallime të qarta. Vlerësimet e lidhura me to nuk duhet të kalohen më tutje pa një reflektim. Kjo ka të bëjë p.sh., me shprehjet normuese dhe vlerësuese si: «Ne duhet ta flasim gjuhën tonë në formën e pastër/të kulluar». Paraqitja e një gjuhe si ‘e kulluar’, ‘e pastër’, ‘e papërzier’ është thjesht konstrukt romantik. Që nga kohët e lashta gjuhët kanë qenë dhe janë në kontakt me njëra-tjetrën dhe nëpërmjet lëvizjeve tregtare dhe të migracionit zhvillohen vazhdimisht. Më pak të kualifikuara janë edhe deklaratat e tilla si: «Ai e flet gjuhën ‘me gramatikë’». Zhvlerësimi i nënkuptuar i dialektit si formë gjuhësore pa gramatikë është, siç u pa më lart, i paqëndrueshëm dhe joadekuat. Një formulim pozitiv i asaj që mund të thonë këto dy deklaratat mund të jetë: «Tani duam t’u përmbahemi normave të gjuhës standarde (për shkak se situata specifike e komunikimit e kërkon një gjë të tillë) dhe fjalët nga gjuhët e tjera t’i përdorim vetëm nëse gjuha jonë nuk e ka fjalën e vet për atë që po mendojmë.»

5. Aspekte pedagogjike

Gjuha – veçanërisht gjuha e parë ose amtare – është element qendror i identitetit të njeriut. Gjuha e parë e shumë fëmijëve dhe të rinjve në migracion është dialekti i tyre/e folmja dialektore e tyre. (Së dyti, ata kryesisht e mësojnë variantin rajonal/dialektor të gjuhës së vendit ku jetojnë; së treti (që nga viti i parë shkollor) mësojnë variantin standard të asaj gjuhe; dhe së katërti, sidomos në mësimin në gjuhën e prejardhjes, variantin standard të gjuhës së tyre të parë).

Nëse mësuesi, në punën me nxënësit, me apo pa vetëdije e zhvlerëson gjuhën të cilën e përdorin prindërit e nxënësve në shtëpi, kjo në aspektin pedagogjik është kundër produktive: në këtë mënyrë gjuha e fëmijës dhe e familjes së tij zhvleftësohet dhe e bën fëmijën të pasigurt dhe dekurajues në një fushë identitare tepër të rëndësishme, shih për këtë më lart në 3. Në aspektin pedagogjik është më e përshtatshme që

mësuesi/-ja t'i bëjë të vetëdijshëm nxënësit për të dy varietetet, dallimet mes tyre dhe fushat e ndryshme të zbatimit.

E njëjta gjë vlen edhe për praktikimin e «përdorimit të përzier të gjuhës» (Code-Mixing) nga shumë nxënës/-e, ku elementet e gjuhës së parë dhe të dytë kombinohen ose «përzihen». Për një kohë të gjatë kjo ishte një gjemb në sy për shumë mësues/-e. Kurse në ndërkohë është bërë e qartë se kjo praktikë (pjesërisht shumë kreative) korrespondon pikërisht me situatën dygjuhësore në të cilën rriten nxënësit në fjalë. Në vend që të zhvlerësohen këto përdorime gjuhësore ose dialekte si «të papastër», ato përdoren më mirë për përmbajtjet interesante mësimore.

6. Aspekte didaktike

Se njohja e nxënësve me gjuhën standarde është një nga detyrat kryesore të mësimin në gjuhën e prejardhjes, u theksua edhe më lart. Megjithatë, kjo nuk duhet ta përjashtojë ballafaqimin me varietetet e tjera – sidomos me dialektet, të cilat nxënësit i sjellin si gjuhë familjare. Përkundrazi, fakti se gjuha jonë përfshin varietete të ndryshme, shërben si pasuri për situata mësimore interesante dhe në aspektin didaktik aktual. Këto situata mësimore ndjekin parimet e zbulimit, njohjes, veprimit dhe të të nxënësit kreativ si dhe përfshijnë në mënyrë optimale njohuritë paraprake dhe resurset e nxënësve.

Nëse nxënësit/-et për shembull përkthejnë tekste nga dialekti në gjuhën standarde (ose kur krijojnë skenë në të cilat njëra ose tjetra formë gjuhësore është në vend të përshtatshëm ose të gabuar), ato bëhen në përputhje me qasjen 'krahasese' me karakteristikat e veçanta dhe normat e gjuhës standarde, në një mënyrë vetëvepruese, zbuluese, që është dukshëm më e lartë se sa dhënia e thjeshtë e njohurive të rregullave dhe normave gjuhësore. Shumë nga propozimet tona mësimore nxisin situata mësimore të këtij lloji; shih p.sh. 1.1–1.3, 2.2, 3.1–3.3. Natyrisht, në këtë formë të mësimdhënies, mësuesi/-ja luan rol gjithashtu të rëndësishëm: nga njëra anë në planifikimin dhe udhëheqjen e situatave përkatëse mësimore, nga ana tjetër si instancë kompetente, p.sh. tek pyetjet për normat gjuhësore standarde dhe përdorimin e përshtatshëm të të dy varieteteve.

Një numër të këshillave konkrete për mësimdhënien, të cilat përkrahin ndërgjegjësimin dhe orientimin mes dialektit dhe gjuhës standarde dhe në të njëjtën kohë i mbështetin aftësitë gjuhësore, veçanërisht në ndërtimin dhe zgjerimin në fushën e gjuhës standarde, janë të shënuara në kapitullin 7. Këto pika vlejné në masë të madhe analoge për mësimin në gjermanisht në zonat dialektore, si p.sh. në Zvicrën gjermanishtfolëse, dhe kjo për të lehtësuar hyrjen në gjuhën gjermane standarde. Sidoqoftë, shumëllojshmëria dialektore e nxënësve zakonisht është më e vogël se në

mësimin në gjuhën e prejardhjes, i cili shpesh vijohet nga nxënës/e të rajoneve të ndryshme dialektore.

Duhet shtuar se mësimi në fushën e gramatikës, e cila përfshin dhënien e njohurive dhe ushtrimin e normave të gjuhës standarde, nuk është temë e kësaj broshure. Përmbajtja e kësaj fushe është e ndikuar fuqimisht nga gjuhët veç e veç; e vetmja gjë me një shtrirje më të gjerë është se ky mësim duhet të bazohet gjithashtu në parimet e një mësimi me nxënësin/-en në qendër, të një mësimi veprues e zbulues. (Për veçoritë e një numri të gjuhëve më të përfaqësuar të migrimit, shih Schader (2013): Gjuha juaj – gjuha ime; krahaso bibliografinë).

7. Propozime konkrete për mësim

- *Të planifikohen situata mësimore edhe për fushën e të shprehurit me gojë*

Mësimi i gjuhës standarde duhet të lidhet me atë se çfarë sjellin nxënësit/et nga shtëpia, d.m.th., në rend të parë me dialektet dhe të folmet dialektore të tyre. Përmes krahasimeve, përkthimeve, luajtjes së roleve, etj, mund të përpunohen dhe të bëhen të qarta veçoritë e gjuhës standarde në një mënyrë të gjallë dhe tërheqëse. Format e mundshme të të mësuarit zbulues, reflektues, veprues dhe nëpërmjet të lojës, janë më të lidhura me shkollën dhe më të qëndrueshme sesa thjesht dhënia e njohurive për rregullat dhe normat gjuhësore. Natyrisht, situatat e të mësuarit duhet të bëhen të përshtatshme për moshën e nxënësve/-eve. Gjithashtu është e qartë se mësuesi edhe këtu luan rol të rëndësishëm në mësim si një autoritet kompetent (shih më lart).

Tek parakushtet e gati të gjithë nxënësve të mësimin në gjuhën e prejardhjes, vlerësohen edhe njohuritë që kanë ata për gjuhën e vendit, në të cilin jetojnë dhe rriten. Jo rrallë, kjo gjuhë – qoftë në dialekt ose në versionin standard – është të paktën po aq e njohur sa edhe gjuha e tyre e parë. Referencat me këtë gjuhë (krahasimet, analogjitë, dallimet) mund dhe duhet të përdoren në mësimin e gjuhës së prejardhjes. Ato mund të japin një kontribut shumë të vlefshëm dhe të orientuar drejt nxënësit, për t'i bërë të qarta veçoritë e gjuhës së parë nëpërmjet të mënyrës krahasuese.

- *Të planifikohen situata mësimore edhe për fushën e të shprehurit me gojë*

Shumë nga këto situata mësimore të mësipërme ndodhin në fushën e të shprehurit me gojë, d.m.th., ato nuk janë të ngarkuara në mënyrë plotësuese me kërkesa më të larta, si në të shkruar. Kjo do të thotë që kjo mënyrë e trajtimit të temës së dialektit-(eve) - gjuhës standarde dhe hyrja në këtë të fundit, është shumë e përshtatshme edhe për nxënësit/et e moshës së re. Nëpërmjet të një planifikimi plotësues dhe sipas niveleve edhe të detyrave me shkrim, shumë situata mësimore bëhen të përshtatshme edhe për përpunim të njëkohshëm nga grupmoshat e ndryshme. Tek propozimet e mëposhtme mësimore i është kushtuar vëmendje e veçantë këtij aspekti, i cili e lehtëson punën e mësuesve/-eve.

- *Mësimi të jetë sa më i integruar në gjuhën standarde, edhe tek puna me partner etj.*

Gjuha standarde duhet të përdoret sa më shpesh të jetë e mundur. Kjo duhet të bëhet veçanërisht edhe nga mësuesi/-ja, i cili/e cila shërben si shembull këtu. Nga ana e nxënësve/-eve, kërkesat mund të klasifikohen sipas moshës ose parakushteve (shih gjithashtu edhe pikën tjetër).

Në mënyrë që nxënësit/et të arrijnë që të bëjnë sa më shumë ushtrime në përdorimin e gjuhës standarde, kjo duhet të kërkohej në mënyrë të përsëritur edhe si medium në punën me partner dhe/ose në punën në grupe. Pikërisht në këto forma sociale biseduese, nxënësit/et gjenden në situata kur mund të flasin më së shumti. Kjo mundësi duhet të shfrytëzohet.

- *Zgjedhje e qartë e gjuhës; të mos ketë përzierje të dialektit dhe standardit*

Në klasë, varietetet dialekt(e)/të folme dialektore dhe gjuha standarde nuk duhet të përzihen. Kjo do të bënte shumë më të vështirë orientimin e nxënësve, veçanërisht të atyre që janë më të vegjël. Nëse një mësim i integruar në gjuhën standarde i mbingarkon disa nxënësit, është me rëndësi gjithsesi të përcaktohet se në cilën situatë ose në cilën sekuençë të të mësuarit, cili varietet është 'miratuar'. Situata të tilla të përcaktuara qartë i përkrahin nxënësit në orientimin e tyre në mes të dy varieteteve. Udhëzimet përkatëse mund të jenë p.sh. si më poshtë: „Ne duam që këtë diskutim sa më shumë që të jetë e mundur ta realizojmë në gjuhën standarde, ju lutem t’i kushtoni vëmendje!“, ose: „Në këtë sekuençë ju mund të flisni edhe në dialekt.“ Në disa klasa të shkollave zvicerane përdoren edhe dy simbole (në formën e shenjave të komunikimit ose me ngjyra të ndryshme): njëra simbolizon që tani përdoret vetëm gjuha standarde, tjetra tregon se zgjedhja e varietetit gjuhësor tani është e lirë.

Në rast të paqartësive me gjuhën standarde, është e rëndësishme të theksohen në mënyrë të përsëritur dallimet në raport me dialektin. Kjo mund të lehtësojë ndërgjegjësimin dhe orientimin midis varieteteve.

- *Sjellje e përshtatshme, korrigjuese sipas situatës specifike- dhe ndërhyrëse*

Nëse nxënësit/-et bëjnë gabime (kjo bëhet kryesisht në gjuhën standarde), ne propozojmë sjelljen e mëposhtme të korrigjimit dhe ndërhyrjes nga ana e mësuesit:

Nuk duhet bërë asnjë korrigjim ose ndërhyrje e detajuar në rrethet e diskutimeve dhe bisedave në të cilat është një përmbajtje në qendër. Korrigjimet e përhershme formale do ta bllokonin komunikimin këtu. Në rastet kur kuptimi është i rrezikuar ose një nxënësi/-eje i mungojnë fjalët ose format e sakta të të shprehurit, mësuesi/-ja mund të ndihmojë ose të përsërisë fjalinë e pasaktë në formën e drejtë.

Nga ana tjetër, korrigjimet e menjëhershme janë të dobishme në sekuencat e hapura të të ushtruarit në të cilat bëhet fjalë, p.sh. për gdhendjen dhe ngulitjen e formave ose ndërtimeve të caktuara. Pikërisht këtu, vëmendja gjuhësore mund të rritet nëse mësuesi thjesht nuk korrigjon, por nëse lejon që klasa të përfshihet në mënyrë aktive. Shembull i një detyre të tillë: „Ne duam të gjejmë fjali në gjuhën standarde, në të cilat të gjitha format e shumës (ose të gjitha ndërtimet relative) janë të sakta. Imagjinoni fjali të tilla; pastaj dëgjoni me vëmendje njëri-tjetrin dhe lajmërohuni nëse keni dëgjuar ndonjë gabim!“.

- *Përdorimi i medieve të reja*

Mundësia e marrjes së informacionit shpejt nëpërmjet të internetit ose nëpërmjet SMS, skype, chat, whatsapp, facebook etj. duhet patjetër të shfrytëzohet. Nxënësit në këtë mënyrë mund t’i pyesin të afërmit e tyre në atdhe për fjalë specifike (varietete dialektore, fjalë të vjetra etj.), ata mund të mësojnë rreth historikut të gjuhës së tyre në internet, mund të krijojnë një listë të fazeve në internet, të cilat japin informacione për rastet e dyshimta etj. E gjithë kjo korrespondon me parimet e të nxënësve dhe të mësuarit e orientuar nga resurset, të mësuarit e pavarur, dhe kështu pasurohet mësimi me impulse dhe informata interesante e të vlefshme.

8. Formulimi i pyetjeve kryesore dhe propozime të përshtatshme mësimore për to

Pasqyra e mëposhtme bazohet në çështjet kryesore të cilat rezultojnë në raport me temën tonë e me qëllim të një mësimi bashkëkohor. Për secilën çështje, në kolonën e djathtë do të gjeni udhëzime për 17 propozimet mësimore, të cilat mund të jenë veçanërisht të dobishme këtu.

• Si mundemi ne si mësues/e që në vend të gjykimeve normative dhe pikëpamjeve, të kemi një qëndrim të hapur respektivisht të çiltër dhe të barasvlershëm ndaj të dy varieteteve?	▶ Hyrja, para së gjithash te kap. 3–7
• Si mund t'ua bëjmë të qartë nxënësve/-eve që të dyja varietetet janë të barasvlershme, por që janë funksionale dhe të rëndësishme në kontekste të ndryshme komunikuese (respektivisht se ato janë të barasvlershme pikërisht për shkak se janë funksionale dhe të rëndësishme në kontekste të ndryshme komunikuese)?	▶ 1.1–1.3 ▶ 2.2 ▶ 3.2 ▶ 4.1–4.3
• Si mund të zgjohet dhe përforcohet vetëdija e nxënësve për varietetet respektivisht dialektet/të folmet dialektore – për gjuhën standarde?	▶ 2.1, 2.2 ▶ 3.1, 3.2
• Si mund t'i përkrahim nxënësit/et tek orientimi mes këtyre dy varieteteve dhe tek përdorimi i tyre sipas situatës?	▶ 1.1–1.3 ▶ 2.2 ▶ 3.1–3.2
• Si mund t'i përkrahim nxënësit/et që të ndërtojnë dhe zgjerojnë njohuritë dhe ndërgjegjësimin e tyre për aspekte të ndryshme të temës dialektet/standardi (fama, ndryshimi gjuhësor, mediumet e reja, etj.)?	▶ 3.3 ▶ 4.1–4.4
• Si mund t'i bëjmë nxënësit/et të vetëdijshëm për atë se çfarë duhet të mësojnë në mënyrë më të thelluar nga gjuha standarde dhe drejtshkrimi i saj?	▶ 1.4–1.5

- Si mund t'i iniciojmë të gjitha këto procese mësimore në mënyrë bashkëkohore dhe të orientuar drejt nxënësve/-eve, që të udhëhiqen nga parimet e të nxënësve, zbulues dhe reflektues? Si mund t'i integrojmë edhe elementet e të mësuarit muzikor-krijues, të mësuarit nëpërmjet të lojës dhe të mësuarit me shumë ëndje?

- ▶ 1.1–1.4
- ▶ 3.1–3.3
- ▶ 4.1–4.4
- ▶ 1.2, 2.2–2.5 (kreativ)

Pjesa 1:
Të zgjohet dhe të zhvillohet
ndërgjegjësimi për varietetet
dialekt(e) – gjuhë standarde

Qëllimi

Qëllimi i propozimeve mësimore 1.1–1.5

Nëpërmjet të një hyrjeje argëtuese, të kapshme edhe për nxënësit më të rinj, në sekuencën 1.1 duhet të zgjohet ndërgjegjësimi ndaj varieteteve të dialekteve/të folmeve dialektore dhe gjuhës standarde. Diskutimi i udhëhequr nga mësuesi/-ja kontribuon në reflektimin dhe thellimin e detyrave të dhëna në sekuencën 1.2. Propozimet mësimore 1.3–1.5 i shërbejnë qëllimit të sensibilizimit të mëtejshëm, të përshtatshëm për të dy varietetet. Në qendër të 1.4 dhe 1.5 është reflektimi i të mësuarit në lidhje me sfidat e gjuhës standarde. Këto sekuenca ndihmojnë për ta bërë punën e ardhshme më të kuptueshme dhe më bindëse për nxënësit/-et në mësimin e gjuhës së prejardhjes.

1.1 Bisedë hyrëse, ndërgjegjësimi i parë

kl. 1–6/9

40–50 min.



Vërejtje paraprake

- Për një thellim përmbajtësor të bisedës hyrëse janë të përshtatshme veçanërisht propozimet mësimore 1.2 dhe 1.3; për nxënësit me njohuri më të përparura gjuhësore edhe 4.1–4.4

Rrjedha:

- Në fillim të mësimin mësuesi/-ja i përshëndet nxënësit/-et në dialektin sa më të veçantë dhe më të gjerë të mundshëm dhe i shton edhe disa fjali për të njëjtën gjë. Pastaj i përsërit të njëjtat edhe në gjuhën standarde. Kjo sekuencë duhet të jetë e gjallë dhe zbavitëse sa më shumë që të jetë e mundur.
- Pyetje/Nxitje: «Thoni se çfarë keni vënë re gjatë dëgjimit! Si mund t'i quajmë të dy format gjuhësore që kam përdorur? Të bëhet një hyrje në termin 'gjuhë standarde' (term më i mirë se 'gjuha e nivelit të lartë'). Nacionet 'dialekti/e folmja dialektore' dhe 'gjuha standarde' të shënohen në tabelë.

Nxitje për diskutim të mëtejshëm (mos shtroni pyetje të mbyllura!)

- Identifikoni situatat tipike në të cilat përdoren dhe përshtaten njëra ose të dyja format! (gjuha standarde për shembull, për lajmet televizive, librat dhe gazetatat, me shkrim; dialekti në shtëpi dhe me shokë/shoqe).
- Kush mund të thotë diçka në dialekt dhe në gjuhën standarde? Provoni! Cili variant është më i njohur për ju; pse?
- Si është kjo në gjuhën e vendit ku jetojmë tani (në gjermanisht për shembull)? Thoni!
- A ekziston në gjuhën tonë vetëm një dialekt/një e folme dialektore? Të mblidhen shembuj të fjalëve në dialekte të ndryshme. Si është kjo në vendin ku jetojmë tani?
- A ekzistojnë edhe forma të ndryshme të gjuhës sonë standarde? Pse jo?
- Cili është kuptimi dhe përdorimi i variantit standard, të cilin pothuajse e kanë të gjitha gjuhët?
- Pse kryesisht e mësojmë gjuhën standarde në mësimin e gjuhës shqipe? Përse është e rëndësishme kjo? (Thellim në propozimin e mësimin 4.1.)

Thellimet (shih gjithashtu propozimet mësimore 1.2, 1.3, 4.1–4.3)

- Diskutoni në grupe dyshe apo treshe se cilat do të ishin pasojat nëse nuk do të kishim një gjuhë standarde të përbashkët. Cilat probleme mund të lindin nga kjo, çfarë mund të ndodhte? (Prej klasës së katërt gjithashtu është e mundur edhe në formë të shkruar ose si pllakat.)

Detyrat për javën e ardhshme (të theksoni se rezultatet janë të rëndësishme për mësimin e ardhshëm!)

- Klasa 1–3 (ndoshta të gjitha klasat): Mblidhni me ndihmën e prindërve tuaj, gjyshërve, etj. fjalë në dialekte të ndryshme/të folme dialektore në gjuhën tonë; shkruajeni në letër dhe gjithashtu shkruajeni se në cilin dialekt/të folme dialektore është!
- Klasa 4–5/6: Mblidhni nga dialektet e ndryshme sinonime (fjalë të ndryshme që kanë kuptim të njëjtë) dhe fjalë të përafërta për fjalët (në gjuhën standarde) vijuese: acar, kasolle, vajzë, djalë, veturë, mësoj, përzë, shikoj, qaj, vallëzoj. Sillni këto fjalë me vete; shënoni, nëse është e mundur, prej cilit dialekt vijnë.
- Klasa 6/7–9: Sillni me vete regjistrime audio nga dialektet e ndryshme (disa fjalë ose fjali). Ndoshta do të gjeni diçka edhe në internet!

1.2 Thellim në vazhdim të detyrave nga 1.1 (në javën e ardhshme)

kl. 1–3/6

45–50 min.



Materiali:

letër me ngjyrë (A4), tabak i madh letre ose letër ambalazhi (A2), harta e trojeve shqiptare ose e vendit mikpritës, thumba për ngjitje të letrave, ngjitës.

Rrjedha:

- Në javën para kësaj sekuence, nxënësit/-et i kanë marrë detyrat e përshkruara si më sipër në 1.1 për mësimin e sotëm. Sot ata sjellin me vete rezultatet e këtyre detyrave; këto do të diskutohen si më poshtë:
- Klasa 1–3 (ndoshta edhe nxënësit më të moshuar, detyra për sot: fjalët nga dialektet e ndryshme të mblidhen dhe të sillen të shkruara në skeda, nëse është e mundur me tregues të së folmes dialektore): Shënimet me fjalët e sjella të ngjiten në tabelë; të klasifikohen (p.sh., sipas dialektit të prejardhjes ose sipas kuptimit). Detyra: „Ju do të merrni letra me ngjyrë. T’i preni ato në formën e petaleve. Shkruani në çdo petal njëren prej fjalëve tuaja. Priteni një rreth për qendrën e lules, si dhe një kërcell. Modeloni lule gjuhësore. Në rrethin e mesit është e shkruar „Gjuha jonë është e pasur“, rreth saj i ngjitni petalet me fjalët e dialektit. „(Gjatë këtij aktiviteti, mësuesi/-ja punon me grupet e tjera.)
- Klasa e 4–5/6-të., eventualisht deri në klasën e 9-të (detyra për sot: nga dialektet e ndryshme të mblidhen (të përshtatet specifika gjuhësore, shih më lart) sinonime për fjalët si ,shkoj’, ,rrufë’, ,dhembje stomaku’, ,flas’, ,flutura’ etj. Detyrë: «Renditni fjalët e sjella (të gjitha për ,dhembjen e barkut’ etj.), secila me të dhënat për dialektin e prejardhjes. Merrni një hartë të zonës sonë gjuhësore. Bëni flamuj të vegjël me gjilpëra me kokë dhe me ngjitës, në të cilët qëndrojnë fjalët. Vendosni flamujt në vendin e duhur në hartë!»

- Klasa e 6./7.–9-të. (Detyra për sot: Të sillen regjistrime të fjalëve në dialekte të ndryshme.) Detyra: «Përgatitni një prezantim të shkurtër të regjistrimeve tuaja; tregoni në hartë se prej nga e kanë prejardhjen; raportoni se si keni arritur t'i bëni këto regjistrime!»
- Përfundimi:
Të tri grupmoshat paraqesin rezultatet e punës së tyre.

1.3 Kur dhe cila formë gjuhësore është e përshtatshme: reflektim, ndërgjegjësim

kl. 1–9

15–20 min.



Materiali i nevojshëm:
letër

Rrjedha:

- Mësuesi/-ja bën një hyrje, detyra:
«Në gjuhën tonë kemi dy variante në përdorim: dialektet/të folmet dialektore dhe gjuhën standarde. Ndonjëherë një variant ose formë përshtatet më mirë, ndonjëherë tjetra. Uluni së bashku në grupe prej dy ose tre vetash dhe shkruani të paktën tri situata ku dialekti përshtatet më mirë dhe të paktën tri situata ku do të duhej të përdoret gjuha standarde!»
- Grupet dyshe ose treshe diskutojnë dhe shënojnë përgjigjet e tyre (rreth 10 minuta).
- Prezantimi dhe diskutimi i rezultateve me tërë klasën; ndoshta të përmbledhen në tabelë.
- Eventualisht të bëhet një vështrim i gjendjes gjuhësore të vendit në të cilin jetojnë nxënësit/-et: Kur dhe për çfarë përdoret këtu dhe cili variant?

Për një thellim skenik të këtij propozimi mësimor shih 2.2.

1.4

Çfarë kemi nevojë të mësojmë nga dhe në gjuhën standarde?

kl. 1–9

45 min.



Materiali:
Fletë të mëdha / pllakate (A2)

Shënim paraprak

Shumica e nxënësve/-eve të mësimi në gjuhën e prejardhjes e njohin nga familja një dialekt/të folme dialektore të gjuhës së parë. Në këtë sekuencë ata do të reflektojnë se cilat elemente të gjuhës standarde janë të rëndësishme për ta për t'i mësuar. Në të njëjtën kohë, ky reflektim mësimor i bën ata të ndërgjegjshëm në punën e tyre në mësimin e gjuhës së prejardhjes, veçanërisht për rëndësinë e gjuhës standarde (si medium i shkrimit dhe i qasjes në fushën e letërsisë) që tashmë është sqaruar në sekuencat e mëparshme.

Meqenëse pretendimet dhe kërkesat në këtë drejtim ndryshojnë varësisht nga grupmoshat dhe parakushtet, ky reflektim bëhet me të tri nivelet.

Çështje metodike:

Pas hyrjes dhe formulimit të detyrës, mësuesi/-sja e shoqëron dhe moderon pyetjen fillimisht për grupin e fillestarëve, pastaj sheh nëse dy grupet e tjera kanë nevojë për mbështetje.

Rrjedha:

- Mësuesi/-ja njofton:
 - «Ne tashmë kemi folur disa herë për dialektet dhe gjuhën tonë standarde. Ne e dimë se gjuha standarde është e rëndësishme për t'u kuptuar në të gjithë zonën tonë gjuhësore, për lexim dhe shkrim dhe për qasje në letërsinë dhe kulturën tonë. Është gjithashtu e qartë se gjuha standarde nuk është e lehtë për të gjithë ne, sepse pjesërisht ndryshon prej dialekteve tona.
 - Sot, ne duam të mendohemi dhe ta bëjmë të qartë se çfarë duam të mësojmë fillimisht nga gjuha standarde: veçoritë e shqiptimit, fjalët, karakteristikat e veçanta në gramatikë, drejtshkrimi etj. Këto mësimet do t'ju ndihmojnë juve që t'i bëni këta hapa në të mësuar!
 - Këto shoshitje do t'i bëjmë në tri grupe (fillestarët, të mesmit, të përparuarit), sepse, natyrisht, kërkesat nuk janë të njëjta për të gjithë. Secili grup do të marrë një letër të madhe (pllakat) në të cilën do të shënojnë çfarë duan ose, më saktë, çfarë duhet të mësojnë nga gjuha standarde në të ardhmen e afërt.»
- Detyrë (në grupe të vogla ose punë me partner):
 - «Mendohuni dhe shënoni në pllakatin tuaj se çfarë është veçanërisht e vështirë për ju në gjuhën standarde dhe në drejtshkrim. Merruni me katër pyetjet e mëposhtme!» (Pyetjet duhet të shënohen në tabelë.)
 - Çfarë doni të mësoni më pas?
 - Cilat janë qëllimet tuaja? Si mund të kontrolloni nëse i keni arritur qëllimet?
 - Si mund t'ju ndihmojë mësuesi/-ja?
 - Çfarë mund të bëni vetë për t'i arritur qëllimet tuaja?
- Në fund të mësimi, secili grup paraqet pllakatin e vet, kurse nxënësit tjerë e komentojnë atë.

1.5 Thellim në drejtshkrimin e gjuhës sonë standarde

kl. 3.–9.

rreth 30–40 min.



Materiali:
Letër (A3)

Rrjedha:

- Mësuesi/-ja bën një hyrje në temë:
«Të shkruhet saktë në gjuhën tonë – d.m.th. në formën standarde –, nuk është gjithmonë e lehtë. Përveç kësaj, edhe shkronjat dhe rregullat ndryshojnë pjesërisht nga ato të gjuhës së vendit në të cilin tani jetojmë»
- Detyra: Mendohuni dhe shënoni në punën me partner:
 - Çfarë më mundon mua/çfarë na mundon neve më së tepërmi kur shkruajmë saktë në gjuhën tonë standarde?
 - Me cilat shkronja dhe tinguj të gjuhës standarde unë kam probleme edhe në dialektin tim?
 - Cilat shkronja/grafema nuk i di në gjuhën e vendit ku unë jetoj tani? Për cilët tinguj përdoren në të dy gjuhët shkronja të ndryshme?
 - Cilat rregulla (për shembull, me shkronjë të madhe, të vogël) ndryshojnë në të dyja gjuhët (gjuha e parë dhe gjuha e vendit ku unë jetoj tani)?
- Prezantimi, diskutimi. Këshilla nga shokët e klasës dhe mësuesi/-ja për mënyrën se si mund të merremi më mirë me drejtshkrimin e gjuhës sonë standarde.

Pjesa 2:
Situata të lojës dhe aktivitete
kreative për sensibilizimin ndaj
varieteteve dialekt(e) – gjuha
standarde

Qëllimi

Qëllimi i propozimeve mësimore 2.1–2.5

Të katër propozimet mësimore të përshkruara këtu, ndihmojnë që nëpërmjet mënyrës së lojës dhe asaj kreative, nxënësit të zhvillojnë një ndërgjegjësim gjuhësor ndaj varieteteve gjuhë standarde/dialekte/të folme dialektore

2.1 Ndjeshmëria akustike

kl. 1–3/5

përafërsisht 10 min.



Ky ushtrim mund dhe duhet të përsëritet disa herë!

Rrjedha:

- Varianti 1: Mësuesi/-ja thotë (ngadalë) një listë të fjalëve dhe frazave. Në këtë listë paraqiten fjalë dhe fraza si nga gjuha standarde ashtu edhe nga dialektet/nga të folmet e ndryshme dialektore. Çdo herë kur mësuesi/-ja e thotë një fjalë në dialekt, nxënësit çohen në këmbë (ose duartrokin apo i bien dyshemesë me këmbë).
- Varianti 2: Mësuesi/-ja tregon një ngjarje të shkurtër në gjuhën standarde (ose e lexon atë para tyre). Në tekst, ai/ajo vazhdimisht përhap fjalë dhe fraza në të folmen dialektore. Sa herë që ai/ajo e bën këtë, nxënësit çohen në këmbë (ose duartrokin apo i bien dyshemesë me këmbë).

Edhe një herë: Ky ushtrim duhet të përsëritet më shpesh. Me kalimin e kohës, listat e fjalëve ose tekstet, mund të përgatiten dhe paraqiten gjithashtu edhe nga nxënësit më të mëdhenj.

2.2 Skena të vogla dhe skeçe për përdorimin e përshtatshëm të të dy varieteteve

kl. 4–9

25–30 min.



Shënim paraprak:

Kjo sekuençë paraqet një thellim dhe zbatim praktik të 1.1–1.3. Kjo duhet të përsëritet disa herë. Për shkak të karakterit të saj zbavitës, ajo jo vetëm që është e përshtatshme për ngritjen e vetëdijes gjuhësore, por shërben edhe për të shtendosur pak mësimin.

Rrjedha:

- Mësuesi/-ja bën një hyrje, detyra:
«Ku, kur dhe cila formë/cili variant i gjuhës sonë (dialekt/gjuhë standarde) përshtatet, këtë e kemi diskutuar tanimë imtësisht. Tani duam të zbulojmë skena të vogla /skeçe. Ju jeni gjithashtu të mirëpritur të mendoni për situata ku dikush e zgjedh formën e gabuar gjuhësore, e cila sjell skeçe argëtuese!»
- Eventualisht mund të mbledhen disa shembuj në klasë, sidomos për përdorim 'të papërshtatshëm' të një varieteti (Shembuj: Kur i adresohemi një mësuesi ose një mjekeje me 'Hej ti', ose nënës duke e lutur me «A do të ishit ju lutem aq e mirë sa ...»).
- Në grupe të vogla me mosha të përziera, nxënësit shpikin dhe provojnë skena të vogla për përdorimin e (pa)-përshtatshëm të njërit prej varianteve (koha: rreth 10 minuta).

- Disa ose të gjitha grupet i luajnë skenat e tyre. Kjo pasohet nga një diskutim i shkurtër: Pse ishte këtu zgjedhja e varieteteve të përshtatshme (ose pse jo); cila ishte arsyeja për anën komike (nëse nuk përdoret siç duhet)?

2.3 Skicime gjuhësore

kl. 2–9

rreth 30 min.



Materiali:
Shabllonet për skicat gjuhësore,
eventualisht lapsa me ngjyrë
(4 ose më shumë ngjyra të
ndryshme).

(Krahaso broshurën 4, Përkrahja e kompetencës ndërkulturore, Nr. 3.1 dhe shabllonet për kopjim, broshura 4, fq. 16/17).

Rrjedha:

- Mësuesi/-ja bën një hyrje:
«Ne rritemi në dhe midis gjuhëve të ndryshme dhe dialekteve/të folmeve dialektore, edhe atë si në gjuhën e parë ashtu dhe në vendin ku jetojmë tani. Disa nga këto gjuhë dhe forma gjuhësore (dialekt/gjuhë standarde) i duam më shumë, të tjerat më pak. Ne mund t'i ilustrojmë këto marrëdhënie, duke i caktuar veç e veç gjuhët individuale dhe format gjuhësore në pjesë të caktuara të trupit (si p.sh. në zemër, në kokë etj).»
- Mësuesi/-ja shpërndan fletët me skicat e një vajze/-një djali.
- Detyra:
«Merrni të paktën katër lapsa me ngjyra të ndryshme. Bëni një legjendë në krye të fletës, p.sh. kështu: e kuqe = gjuha ime e parë në dialekt, vjollcë = gjuha ime e parë në formë standarde, e kaltër = gjuha e folur këtu në dialekt (për shembull, gjermanishtja e Cyrihut), kafe = gjuha e folur këtu në formën standarde.»

Shënim: Ky aktivitet mund të shtrihet lehtësisht për të përfshirë edhe gjuhë të tjera të nxënësve/-eve (gjuhë të huaja që mësohen në shkollë, gjuhë nga mjedisi i nxënësve).

2.4 «Poezi njëmbëdhjetëshe» në dialekt(e) dhe në gjuhën standarde

kl. 2–9

30–45 min.



Materiali:
Letër në dy ngjyra
(A4 ose A5).

(Për 'njëmbëdhjetëshen' shih broshurën 1, Përkrahja e të shkruarit, Nr. 21.1 Natyrisht, mund të zgjidhet edhe një formë e thjeshtë e poezive.)

Rrjedha:

- Mësuesi/-ja ua shpjegon nxënësve 'planin e ndërtimit' të një poezie njëmbëdhjetëshe (5 rreshta, gjithsej 11 fjalë: rreshti 1: 1 fjalë, rreshti 2: 2 fjalë, rreshti 3: 3 fjalë, rreshti 4: 4 fjalë, rreshti 5: 1 fjalë; për detaje më të hollësishme shihni broshurën 'Përkrahja e të shkruarit', nr. 21.1).
- Të krijohen 1–2 njëmbëdhjetëshe, derisa të gjithë ta kenë kuptuar parimin.

- Detyra:
«Të shkruhen në punën me partner një ose dy poezi njëmbëdhjetëshe mundësisht sa më bukur të jetë e mundur në gjuhën standarde (për shembull, në letër të kuqe) dhe dy në dialekt (për shembull, në letër të verdhë)!» (Tema mund të jetë e lirë apo e paracaktuar: për shembull, vera, macet, pushimet verore... .)
- Secili grup dysh lexon njëmbëdhjetëshet e tyre dhe i ngjet në tabelë. Nxënësit e tjerë i komentojnë.

Zgjerim në temë:

- Fletët të modelohen bukur; të bëhen një ose dy libra me to.
- Poezitë të incizohen, p.sh. të memorizohen në MP3.
- Poezitë të prezantohen në një mbledhje me prindër.

2.5 Flluska folëse për foto ose piktograme në dialekt dhe në gjuhën standarde

kl. 3–9

përafërsisht 30 min.



Materiali:

Fotot ose piktogramet (shenjat e trafikut etj.) të sillen nga mësuesi/-ja ose nxënësit (si detyrë shtëpie); letër, gërshtë, ngjytës.

Rrjedha:

- Ne i shikojmë fotografitë ose piktogramet dhe mendohemi se çfarë flluska fjalësh janë të përshtatshme për to: Çfarë mund të thonë njerëzit në foto? Çfarë mund të na thonë piktogramet (p.sh. shenjat e komunikacionit)? Këto dëftime mund të bëhen në dialekt ose në gjuhën standarde. Të bëhen disa shembuj për të dy varietetet
- Nxënësit do të marrin letër, gërshtë dhe ngjytës. Individualisht ose në çift duhet t'i presin flluskat e fjalëve, teksti për flluskat e fjalëve në dialekt (për shembull me ngjyrë të kuqe), respektivisht në gjuhën standarde (për shembull me ngjyrë të kaltër).
- Prezantim dhe diskutim i ndërsjellë.

Pjesa 3:
Të mësuarit zbulues për temën
dialekt(e) – gjuha standarde

Qëllimi i propozimeve mësimore 3.1–3.3

Propozimet mësimore 3.1–3.3 synojnë që nëpërmjet të të mësuarit kërkues dhe zbulues të zhvillojnë vetëdijen dhe interesimin e nxënësve ndaj varieteteve dialekt(e) dhe gjuhës standarde. Në të njëjtën kohë, krahasimet e këtij lloji nxisin orientimin midis dy varieteteve. Me rëndësi: Ushtrimet e mëposhtme duhet të përsëriten disa herë.

3.1 Krahasimet dhe përkthimet dialekt(e) – gjuha standarde

kl. 2/3–9

përafërsisht 45 min.



Materiali:
6 tekste të shkurtra (shih më poshtë tek vërejtje paraprake).

Ky ushtrim mund dhe duhet të përsëritet disa herë!

Shënim paraprak për tekstet:

Mësuesi/-ja përgatit 6–8 tekste të shkurtra me rreth 4–7 fjali secili. 3–4 tekste janë të shkruara në gjuhën standarde dhe 3–4 në një ose në disa dialekte. (Mënyra më e lehtë është nëse mësuesi/-ja i shkruan vetë tekstet, nëse është e mundur, tekste me gjatësi dhe kërkesa të ndryshme. Në këto tekste duhet të jenë të dukshme dallimet tipike mes dialektit – standardit.) Nga një tekst në dialekt dhe gjuhën standarde duhet të jetë i vendosur në tabelë (ose në projektor apo si pllakat), tekstet tjera si kopje veç e veç.

Rrjedha:

Hyrja: «Në tabelë (ose në projektor/në pllakat) është një tekst i shkurtër në dialekt/në të folme dialektore. Lexojeni këtë tekst!»

Nxitje/pyetje për diskutimin vijues:

- Çfarë vëreni në këtë tekst (krahasuar me tekstet e tjera të cilat i kemi lexuar tashmë)?
- Si e dini që teksti nuk është shkruar në gjuhën standarde? Emërtoni dallimet sa më saktë që të jetë e mundur! (Mund të bëhet në tabelë një listë e dallimeve më të rëndësishme.)
- Tani do të përpiqemi që këtë tekst ta sjellim në formën standarde të gjuhës, d.m.th. për ta ,përkthyer’ atë! Nxënësit më të përparuar e bëjnë këtë me shkrim vetëm/individualisht ose në çift; mësuesi/-ja i ndihmon fillestarët/et.
- Krahasimi i rezultateve/përkthimeve.
- A mund të formulojmë tashmë një formë të rregullave për dallimet ndërmjet dialektit /gjuhës standarde? Këto shënohen në tabelë.

Thëllimi 1:

- Mësuesi/-ja tregon një tekst në gjuhën standarde. Nxitje: «Le të përpiqemi të përkthejmë këtë tekst në dialektin tonë (ndoshta në disa prej dialekteve tona)!» Nxënësit më të përparuar e bëjnë këtë me shkrim (vetëm ose në çift); mësuesi/-ja i ndihmon fillestarët/et.
- Krahasimi i rezultateve/përkthimeve.

Thëllimi 2:

- Mësuesi/-ja shpërndan fletët me tekste në dialekt. Detyra: Të ,përkthehen’ në gjuhën standarde (në grupe dyshe).
- Secili ekip paraqet rezultatet e tij, këto rezultate komentohen nga nxënësit e tjerë.

Thellimi 3 (ndoshta edhe si detyrë shtëpie, tek e cila prindërit mund të ndihmojnë):

- Mësuesi/-ja shpërndan fletët me tekste në gjuhën standarde. Detyra: „përktheni” në dialektin tuaj (në grupe dyshe).
- Secili ekip prezanton (ndoshta vetëm në javën e ardhshme) rezultatet e tij, këto komentohen nga nxënësit e tjerë.

Përfundimi:

- Diskutim në klasë: «Cilat janë dallimet kryesore që i kemi zbuluar mes gjuhës standarde dhe dialektit (tingujt, leksiku, format, etj.)?» Të shënohet në dërrasën e zezë në formë të tabelës (standard/dialekt); të dokumentohen nga nxënësit në fletoren e gjuhës. (Nxënësit e përparuar do të bëjnë një thellim në mësimin 3.2, shih më poshtë).

3.2 Krahase thelluese dhe ndërgjegjësimi për dialektin(et) – gjuhën standarde

kl. 5/6–9

përafërsisht 45 min.



Materiali:

Tekste të shkurtra dhe të mesme (1/4-1/2 e faqes) në gjuhë standarde dhe në dialekte, që do të përgatiten nga M ose – si detyrë – që do të sillen nga N. Tabela si kopje (shih më poshtë).

Rrjedha:

- Në vazhdim të krahasimeve dhe përkthimeve të mësipërme (krahaso 3.1), nxënësit e përparuar do të marrin tekstet në gjuhën standarde dhe në dialekte të ndryshme.
- Detyra: «Ju do të merrni një tabelë. Plotësojeni këtë pasi t’i keni shqyrtuar me kujdes tekstet në dialekt dhe në standard!»
- Secili ekip paraqet rezultatet e tij, këto rezultate do të komentohen nga nxënësit e tjerë.

Modeli për tabelën:

Titulli i tekstit tonë:		
Shembuj për ...	Dialekt	Gjuhë standarde
Shqiptime të ndryshme të tingujve		
Fjalë të ndryshme		
Forma të ndryshme		
Konstrukte të ndryshme		

3.3

Paraqitja veç e veç e dialekteve dhe veçantitë e tyre

kl. 5/6–9

përafërsisht 20–45 min.



Materiali:

Tekste dhe incizime të sjella nga N;

Harta e trojeve shqiptare.

Shënim paraprak, detyra e mëparshme:

Ky mësim është veçanërisht i përshtatshëm për klasat me nxënës më të përparuar dhe me një varg varietetesh të ndryshme dialektore. Nxënësit marrin për këtë sekuencë këtë detyrë: 1.) të informohen nga të afërmit e tyre ose në internet (ku ka shumë vjegëza për dialektet) në lidhje me dialektin e tyre të prejardhjes dhe 2.) ta përpunojnë këtë informacion për një prezantim të shkurtër; nëse është e mundur me shembuj konkret të incizuar. Ju do të merrni listën e mëposhtme me pikat të cilat prezantimi juaj duhet t'i përfshijë:

- Ku flitet ky dialekt?
- Çfarë është karakteristike/tipike për këtë dialekt sa i përket shqiptimit (fonologjisë), çfarë për leksikun (veçoritë leksikore), çfarë për krijimin e formës dhe të konstrukteve të veçanta (morfologjinë, sintaksën)?
- Cilat janë dallimet kryesore të këtij dialekti/të kësaj së folmeje dialektore në raport me gjuhën standarde?

Rrjedha:

- Nxënësit të cilët e kanë përpunuar këtë detyrë, ia paraqesin klasës dialektin e tyre në mënyrë sa më të detajuar. Prezantimi u referohet pikave të përcaktuara të mësipërme. Të dëshirueshëm janë shembuj me incizime autentike.
- Pas çdo prezantimi bëhet një diskutim, nëse është e mundur duke bërë krahasime me dialekte të tjera.

Pjesa 4:
Reflektim gjuhësor për temën
dialekt(e) – gjuhë standarde

Qëllimi

Qëllimi i propozimeve mësimore 4.1–4.4

Propozimet e mëposhtme thellojnë njohuritë e bëra në bisedën hyrëse (shih më lart propozimin mësimor 1.1) dhe në aktivitetet vijuese. Qëllimi i tyre është forcimi i mëtejshëm i vetëdijes së nxënësve mbi të dy varietetet. Kjo duhet të bëhet nga shumë perspektiva dhe në mënyrë jo vlerësuese, kështu që tek nxënësit të krijohet interesimi dhe qëndrimi pozitiv ndaj të dy varieteteve.

Propozimet mësimore 5.1 dhe 5.2 ndërtohen mbi njëri-tjetrin dhe duhet edhe të përpunohen në këtë mënyrë. Në pikën 5.3, fokusi nuk qëndron vetëm tek gjuha por edhe tek reflektimi në të mësuar.

4.1 Përse ka dialekte/të folme dialektore dhe një gjuhë standarde?

kl. 1–9

30–45 min.



Materiali:
Harta e trojeve shqiptare.

Shënime paraprake, çështje organizative:

- Në këtë diskutim 'gjuhësor-filozofik' në klasë, duhet të marrin pjesë të gjithë nxënësit dhe të kontribuojnë me idetë apo spekulimet e tyre. Në mënyrë që të rinjtë të mos bllokohen nga njohuritë e më të moshuarve, më së miri është që klasa të ndahet në tri grupe (nxënës të rinj, të mesëm, më të moshuar). Mësuesi/-ja ua ndan temën të gjithëve dhe ua jep disa pika të rëndësishme diskutimi (shih më poshtë), pastaj të tri grupet diskutojnë veç e veç. Më në fund secili grup do të paraqesë atë që ka përpunuar respektivisht krijuar. Është e mundshme që mësuesi/-ja të ulet me grupin e më të rinjve, por aty sillet sigurisht shumë i përmbajtur.
- Detyrat për grupet mund të dallohen për nga niveli i kërkesës; po ashtu edhe kërkesat për prezantimin (prezantim i thjeshtë, modelim i një pllakati me 'tezat').
- Gjithashtu është e mundshme që nxënësit e nivelit të mesëm dhe të lartë t'iu përgjigjen pyetjeve me shkrim dhe pastaj këto tekste të lexohen dhe diskutohen.
- Referencat për gjendjen gjuhësore të vendit në të cilin jetojnë nxënësit, sigurisht janë të mundshme dhe të dobishme.

Rrjedha:

- Mësuesi/-ja njofton: «Tema jonë sot është: Përse ka në gjuhën tonë dialekte/të folme dialektore të ndryshme dhe pse kemi përveç tyre edhe një gjuhë standarde? Ne duam të merremi me këto pyetje në tri grupe.» Tema shënohet në tabelë.
- Detyra: «Diskutoni me rend pyetjet e mëposhtme!» (Pyetjet shkruhen në tabelë ose u dorëzohen si kopje):
 - Cilat mund të jenë arsyet se pse gjuha jonë, varësisht nga regjioni, flitet në dialekte/të folme të ndryshme dialektore?
 - Pse është ashtu që ne kemi një gjuhë standarde përveç dialekteve? Si ka ndodhur kjo; kush e ka 'shpikur' dhe i ka përcaktuar rregullat e saj?
 - Cila është dobia dhe përparësia e gjuhës standarde?
 - A ka edhe vështirësi në raport me gjuhën standarde?
 - Cila është dobia dhe përparësia e dialekteve/të folmeve dialektore?
 - Çfarë mund të jetë problematike tek dialektet?

- Detyra: «Shënoni idetë tuaja me disa fjalë kyçe, në mënyrë që më vonë t'ua thoni nxënësve të tjerë supozimet tuaja.»
- Në përfundim të tri grupet i prezantojnë dhe i diskutojnë rezultatet e tyre.
- Produktive është gjithashtu edhe pyetja: «Cila është gjendja gjuhësore e vendit në të cilin jetoni tani? Çfarë dini ju për dialektet dhe gjuhën standarde në këtë vend?»

Thellimi (veçanërisht për klasat 7–9):

- Si detyrë shtëpie u jepet nxënësve më të përparuar në aspektin gjuhësor që të informohen nëpërmjet të internetit rreth historisë së gjuhës sonë dhe që të përgatitin disa prezantime ose referime të shkurtra. Nxitje për këtë (të ndahen në disa grupe të ndryshme dyshe ose treshe):

Histori gjuhe:

- Kërkoni në internet ose në libra informacione mbi historinë e gjuhës sonë dhe shpërndarjen e saj në të kaluarën dhe sot; modeloni një prezantim të vogël!
- Kërkoni në internet ose libra shembuj të teksteve shumë të hershme (ose të para) në gjuhën tonë; modeloni një prezantim të vogël!

Për gjuhën tonë standarde:

- Kërkoni në internet ose në libra informacione mbi historinë e gjuhës sonë standarde! Kur u përcaktua në formën e tanishme, cilat institucione/individë /instanca ishin të përfshira në këtë çështje, cilat ishin rregullat më të rëndësishme?
- Informohuni: A ekziston një mekanizëm zyrtar rregullues për gramatikën e gjuhës sonë standarde? A është i rregulluar zyrtarisht edhe drejtshkrimi ynë, a ka një vepër referimi në stilin sikur Duden në gjermanisht?
- Hulumtoni: Cilat uebfaqe (websites) në internet na japin informacione për çështjet gjuhësore dhe drejtshkimore në lidhje me gjuhën tonë standarde; Ku mund të gjejmë informacione në lidhje me historinë dhe shpërndarjen e gjuhës dhe dialekteve tona? Bëni një listë të vjegëzave për to.

- Prezantimi i rezultateve në formë të referateve të shkurtra (5–10 min.).

4.2 Rreth prestigjit të dialekteve/të folmeve dialektore dhe gjuhës standarde

kl. 4–9

30–45 min.



Shënim paraprak:

Në shumë gjuhë dialektet/të folmet dialektore kanë prestigj të ulët/negativ në krahasim me variantin standard, krahaso kap. 2-4 në hyrje. Në anën tjetër, disa nxënës/-e kanë një antipati ndaj gjuhës standarde të cilën ata e shohin si ,shumë të vështirë’ dhe ,të huaj’. Ky diskutim në klasë ka të bëjë me ndërtimin e një qëndrimi të barabartë dhe pozitiv ndaj të dy varieteteve. Vlerësimet dhe paragjykimet e tilla si «gjuha standarde = gjuhë ,e pastër’» ose «gjuha standarde = gjuhë me gramatikë; dialekti = pa gramatikë» (por gjithashtu: «gjuha standarde = shumë e vështirë dhe e padobishme») duhet të konsiderohen si të gabuara dhe të padrejta.

Shënim: Sekuenca përfaqëson një thellim të 4.1, krahaso gjithashtu 1.1–1.3.

Çështje metodike:

Në vend që nxënësit të hyjnë drejtpërdrejt në diskutim me pyetjet e mëposhtme, ata së pari duhet të mendojnë vetëm ose në grupe dyshe dhe mendimet e tyre t’i shënojnë me fjalë përmbledhëse. Kjo sekuençë gjithashtu mund të organizohet si diskutim për/kundër midis të dy grupeve të nxënësve.

Rrjedha:

- Mësuesi/-ja njofton: «Ne jemi konfrontuar disa herë me temën dialektet/të folmet dialektore dhe gjuha standarde. Ne gjithashtu kemi shprehur mendimet për përfitimet dhe vështirësitë që lidhen me të dy format. Sot duam të diskutojmë pyetjet e mëposhtme» (të shënohen në tabelë):
 - Variantet ,dialekt/e folme dialektore’ dhe ,standard’ nuk janë po aq të popullarizuara tek të gjithë njerëzit. Disa njerëz preferojnë dialektet, disa e vlerësojnë gjuhën standarde në një nivel më të lartë. Mendohuni: Cilat mund të jenë arsyet për këto dy qëndrime?
 - Nganjëherë dëgjohej se vetëm gjuha standarde është gjuhë ,e pastër’, vetëm ajo ka një gramatikë. Dialektet ose të folmet dialektore do të ishin pra të ,papastra’ dhe ,pa gramatikë’. Çfarë qëndrimi duhet të mbahet nga deklaratat e tilla? Diskutoni!
 - Gjeni shembuj ku natyrisht edhe në dialekte/të folme dialektore kanë një gramatikë - edhe nëse kjo ndryshon pjesërisht nga gramatika e variantit standard!
 - Çfarë dini për prestigjin/imazhin e dialekteve dhe të gjuhës standarde në gjuhën e vendit ku jetoni tani, çfarë marrëdhënie kanë njerëzit këtu me këto dy variante?

4.3

Gjuha jonë: thellim në ndryshimin e gjuhës dhe të fjalëve të huaja

kl. 5/6–9

përafërsisht 30 min.



- Hyrje nga ana e mësuesit-es:

«Gjuhët ndryshojnë me kalimin e kohës. Fjalët e vjetra zhduken, të rejat – shpesh nga gjuhët e tjera – hyjnë brenda. Kjo ka qenë gjithmonë kështu dhe nuk është shkas për nervozizëm. Megjithatë, e vlen të mendohemi se nëse disa fjalë të huaja janë vërtet të nevojshme, ose nëse gjuha jonë i ka fjalët e saj për të shprehur kuptimin e asaj që është menduar».

- Nxitje për diskutim:

- Çfarë fjalësh të huaja njihni në gjuhën tonë? Prej nga kanë ardhur fillimisht këto fjalë? Mendohuni dhe mbani shënime në grupe dyshe.
- Prezantimi i listave
- Diskutim: Për cilat nga këto fjalë do të kishte një fjalë të saj gjuha jonë?
- Për çfarë arsyeje ka thjesht fjalë të huaja, përse dhe nëpërmjet të cilave rrugë hyjnë ato në gjuhën tonë?
- Nga cila gjuhë vijnë sot shumica e fjalëve të huaja? Përse është kjo kështu?
- Si është kjo në gjuhën e vendit, në të cilin ne jetojmë?
- Edhe diçka rreth fjalëve 'të vjetra': A njihni fjalë në gjuhën tonë që vështirë se përdoren më? Mendoni para së gjithash për dialektet/të folmet dialektore!

- Thellim, detyra

- Mblidhni në shtëpi fjalë të tjera të huaja në gjuhën tonë dhe sillni me vete herën tjetër. Gjithashtu kushtojini vëmendje përdorimit gjuhësor në gazeta dhe televizion.
- Shënoni për çdo fjalë të huaj – nëse është e mundur – një fjalë nga gjuha jonë e cila mund ta zëvendësojë këtë fjalë të huaj.
- Pyetni në familjet tuaja dhe tek të afërmit tuaj për fjalët të cilat vështirë se përdoren më! Bëni një listë dhe silleni atë me vete!
- A gjen dikush në internet ose në libra një dokument në një formë shumë të hershme të gjuhës sonë dhe këtë t'ua paraqesë nxënësve të tjerë? (Krahaso 4.1.)

–

- Rezultatet e sjella duhet të paraqiten dhe komentohen në njërën nga orët e ardhshme.

4.4 Përdorimi i gjuhës në mediet e reja (SMS, e-mail, chat, etj.)

kl. 4–9

përafërsisht 30 min.



Materiali:
Letër (A3)

- Mësuesi/-ja bën një hyrje në temë:

«Nëse ne në të ashtuquajturat media të reja apo media sociale komunikojmë nëpërmjet të – SMS, e-mail, chats, whatsapp, facebook ose twitter – shpesh nuk u përmbahemi rreptësisht normave që zbatohen për gjuhën e shkruar standarde. Ne përdorim emocione (figurina etj.), fjalët e dialektit, shkurtesat dhe fjalë nga gjuhët e tjera.»

-
- Nxitja 1 për diskutimin

- Mendohuni dhe shënoni në grupe dyshe shembuj të këtij përdorimi të veçantë, ashtu siç e keni përdorur ju tashmë!

- Prezantimi, diskutimi.

-
- Nxitja 2:

- Shkruani një SMS një shoqeje/një shoku në lidhje me një temë që keni zgjedhur. Përdorni aty të gjitha emocionet (figurinat etj.), fjalë në dialekt, shkurtesa dhe fjalë nga gjuhë të tjera që ju normalisht do t'i përdornit! Shkruani SMS në një fletë A3 kështu që ju pastaj mund t'ia tregoni atë klasës. Markoni/nënvizoni çdo gjë që devijon nga gjuha e shkruar 'normale' dhe shpjegojani atë shokëve/shoqeve të klasës!

- Prezantimi, diskutimi.

Pjesa 5: Propozimi për planifikim mësimor

Vërejtjet paraprase:

- Çdo bllok planifikimi mbulon temat për rreth 3 javë. Blloqet mund të kryhen ose njëra pas tjetrës, ose, akoma më mirë, të shpërndara gjatë një semestri ose viti shkollor.
- Disa propozime mësimore (veçanërisht 2.1, 2.2, 3.1) mund dhe duhet të përsëriten disa herë pavarësisht nga blloqet.

Blloku 1 (5 orë)

Java	Ora	Fillestarët (Kl. 1–3)	Të mesmit (Kl. 4–5/6)	Të përparuarit (Kl. 6/7–9)
1	1.	(Tema tjetër)		
	2.	1.1 Bisedë hyrëse, 40–50 min.; dhënia e detyrave për javën tjetër		
2	1.	1.2 10' në 3 grupe, pastaj nga 12 min. prezantim i detyrave, 45 min.		
	2.	1.3 Kur dhe cila formë gjuhësore është e përshtatshme? 15 min. 2.1 Ushtrim për ndjeshmërinë akustike, 10 min. 2.2 Nxënësit përgatitin skeçe të shkurtër, 10 min. 2.2 Paraqitja e skeçeve mbi përdorimin e dialektit/standardit, 25 min.		
3	1.	3.1 Krahasime dhe përkthime dialekt – standard, 45 min.		
	2.	1.4 Çfarë duam dhe duhet të mësojmë ne nga gjuha standarde? 45 min. në tri grupe me nivele përkatëse		

Blloku 2 (6 orë)

Java	Ora	Fillestarët (Kl. 1–3)	Të mesmit (Kl. 4–5/6)	Të përparuarit (Kl. 6/7–9)
1	1.	1.3 Kur dhe cila formë gjuhësore është e përshtatshme? Të tematizohet edhe një herë ose: 2.1 , Sensibilizimi akustik, 10 Min. 3.1 Krahasime dhe përkthime dialekt – standard, 35–40 min.		
	2.	2.4 «Poezi njëmbëdhjetëshe» në dialekt dhe standard; prezantimi, 45–50 min.		
2	1.	4.1 Pse ka dialekte dhe gjuhë standarde? Diskutime në 3 grupe nivelesh, 30–45 min.		
	2.	2.3 Skica gjuhësore, rreth 20 min. 2.5 Filluska folëse për fotografitë etj. në dialekt dhe standard, 30 min. (eventualisht detyrë tjetër për nxënësit e ciklit të ulët)		
3	1.	Detyrë tjetër ose përsëritje 2.1, 2.4, 2.5, 1.2 (lulet gjuhësore)	3.2 Krahasime thelluese standard – dialekte, 45 min.	
	2.		4.4 Përdorimi i gjuhës në mediet e reja, 30 min.	

Bloku 3 (4 orë)

Vërejtje paraprake:

1. Për paraqitjen e dialekteve veç e veç dhe për referate të shkurtër në orën e dytë të javës së 2-të, duhet që nxënësit më të përparuar të marrin detyrat përkatëse para javës së parë dhe të dytë!
2. Ky bllok u drejtohet kryesisht nxënësve të grupit të mesëm dhe të përparuar (klasa e 5–9-të). Për më të rinjtë, do të duhej të sigurohen detyra të tjera, që të mund të punojnë mundësisht në mënyrë sa më të pavarur.

Java	Ora	Fillestarët (Kl. 1–3)	Të mesmit (Kl. 4–5/6)	Të përparuarit (Kl. 6/7–9)
1	1.	1.5 Reflektimi i të mësuarit: Çfarë duhet të mësojmë për drejtshkrimin e gjuhës sonë? (30-40 minuta)		
	2.	Event. përsëritje 2.1 , shih më tej shënimin paraprak 2	4.3 Thellim në shndërrimet gjuhësore dhe fjalët e huaja, 30 min. 3.3 Prezantimi i dialekteve veç e veç, 20 min.	
2	1.	Event. përsëritje 2.1 , shih më tej shënimin paraprak 2	4.2 Rreth prestigjit të dialektit dhe standardit, 30–40 min.	
	2.		4.1 Prezantime të nxënësve për aspekte të veçanta, shih nxitjet thelluese tek 4.1, 20–40 min. 3.3 Event. Prezantimi i dialekteve veç e veç, 20 min.	

Literatura e shfrytëzuar

- Becker-Mrotzek, Michael (2006): Mündlichkeit – Schriftlichkeit – Neue Medien. In: Ursula Bredel u. a. (Hrsg.): Didaktik der deutschen Sprache. Paderborn: Schöningh; S. 69–89.
- Christen, Helen u. a. (2013): Kleiner Sprachatlas der deutschen Schweiz. Zürich: Huber.
- Erfurt, Jürgen (Hg.; 2003): «Multisprech»: Hybridität, Variation, Identität. Osnabrück: Redaktion OBST (= Osnabrücker Beiträge zur Sprachtheorie, Band 65).
- König, Werner (2015): dtv-Atlas zur deutschen Sprache. München: dtv.
- Luchtenberg, Sigrid (2008): Language awareness. In: Bernt Ahrenholz; Ingelore Oomen-Welke (Hrsg.): Deutsch als Zweitsprache. Baltmannsweiler: Schneider Hohengehren (= Deutschunterricht in Theorie und Praxis, Band 9); S. 107–117.
- Neuland, Eva (2006): Sprachvarietäten – Sprachnormen – Sprachwandel. In: Ursula Bredel u. a. (Hrsg.): Didaktik der deutschen Sprache. Paderborn: Schöningh; S. 52–68.
- Schader, Basil (2013): Deine Sprache – meine Sprache. Handbuch zu 14 Migrationssprachen und zu Deutsch. Zürich: Lehrmittelverlag Zürich.
- Schader, Basil (2013): Sprachenvielfalt als Chance. Hintergründe und 101 praktische Vorschläge für den Unterricht in mehrsprachigen Klassen. Zürich: Orell Füssli.
- Shkurtaj, Gjovalin (2016): Dialektet e shqipes. Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore (...). Tiranë: Botimet Morava.
- Sieber, Peter; Horst Sitta (1986): Mundart und Standardsprache als Problem der Schule. Aarau/Frankfurt a.M./Salzburg: Sauerländer.
- Wandruszka, Mario (1979): Die Mehrsprachigkeit des Menschen. München: Piper.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes (HSU)» përmbledh një radhë të vëllimeve, të cilat kontribuojnë në cilësinë e mësimin në gjuhën e prejardhjes si edhe në lidhjen e saj të mirë me mësimin e rregullt.

Adresantët e kësaj serie janë mësuesit e ardhshëm dhe ata që praktikojnë MGJP-në, si edhe institucionet që përgjigjen për ta në vendet e prejardhjes dhe të emigrimit.

Vëllimi i bazave (doracaku dhe libri i punës. Bazat dhe arsyet) transmetojnë ndër të tjera, pikat më të forta të pedagogjisë, didaktikës dhe metodikës aktuale në Evropën Perëndimore dhe Veriperëndimore.

Vëllimet me nxitje didaktike ofrojnë impulse konkrete dhe planifikime për sfera të ndryshme të mësimin (përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë etj) Të gjitha vëllimet lindën në bashkëpunim të ngushtë me mësues që praktikojnë MGJP-në, kështu që lidhja me praktikën dhe zbatueshmëria konkrete është bashkëmenduar që në krye.

Seria përfshin vëllimet e mëposhtme (pa broshurat plotësuese):



Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» botohet në gjermanisht, anglisht, shqip, në gjuhën boshnjake, kroate, serbe, portugalisht dhe turqisht. Ajo do të publikohet nga Qendra IPE (International Projects in Education) e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut.